
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 12.04.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: AROMA PLUS shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës”**, me Nr. të Prok: **616-23-1001-2-1-1**, Autoriteti Publik – Komuna e Prishtinës me datë: **12.04.2023** nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet në tërësi kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: AROMA PLUS shpk e parashtruar me datë: 12.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-1001-2-1-1, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK –së, të datës 07.04.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.**
2. **Autoriteti Kontraktues, mbështet vendimin për të vazhduar lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës”, me Nr. të Prok: 616-23-1001-2-1-1.**
3. **Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

Arsyetim

Autoriteti Publik me datë: 07.04.2023 ka bërë Njoftimin mbi Vendimin në web-faqe të KRPP-së duke respektuar nenin 16 par.2 shkronja L të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022..

Operatori Ekonomik në bazë të nenin 108/A ka ushtruar mjetin juridik kërkesë për rishqytim me datë: 12.04.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së të datës: 07.04.2023, i cili ka paraqitur pretendimet ankimore si në vijim:

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
Përshtetja rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqytim.

Te pa kënaqur me njoftimin e date 07.04.2023 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Kuvendi i Komunes se Prishtines ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi i objekteve per shkollat fillore ne Komunen te Prishtines me nr te prokurimit: 616-23-1001-2-1-1 ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrveshjeve, ushtrojmë këtë:

KËRKESE PËR RISHQYRTIM

Për shkak se AK- Kuvendi i Komunes se Prishtines:

1.
 - Ne mënyrë te kundërligjshme na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.
2.
 - Ne mënyrë te kundërligjshme ka rekomanduar per dhënie te kontrates nje OE qe nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

1.
Sqarojmë ne mënyrë te detajuar :
Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunes se Prishtines me datën 07.04.2023 ka bere publikimin e njoftimit B58-Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, padrejtësisht na ka eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit, pasi qe AK ne arsye te eliminimit ka cekur se " *I mungon deklarata mbi Operimin (shpeshësia e pastrimit të Siperfaqeve sipas paramases) min.1 here max 3 here* " kjo arsye e eliminimit eshte e kundërligjshme, pasi qe ne NJK dhe DT nuk eshte kerkuar nje kerkese e tille dhe AK nuk ka te drejte qe ta eliminoj nje OE per nje kerkese te cilen nuk e ka cekur ne NJK dhe DT.

Faqe 4 nga 10

AK na ka eliminuar ne kundërshtim me nenin 56.3 te LPP-së ku thuhet: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"

Neve mund te ju sigurojme me dhjetra vendime te OSHP-se ku nuk ka qene kerkese d osjes se tenderit dhe OSHP nuk ka lejuar qe te eliminohet nje OE nese AK nuk e ka parapare si kerkese per vleresim. Si shembull po ju japim vendimin me PSH. nr. 741/22 ku thuhet si me poshtë:

Duhet theksuar se parimet kryesore të procedurës së vlerësimit, sipas LPP, ndër të tjera janë që: [...] Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kriterëve të specifikuar të dhënies së kontratës dhe se vetëm kërkesat dhe kriteret e dhënies së kontratës të specifikuar në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim.

Neve ju kemi përmbajte kërkesave te AK-se te vendosura ne NJK dhe DT andaj AK kundërligjshëm na ka eliminuar nga ky aktivitet te prokurimit.

2.

- Ne mënyrë te kundërligjshme ka rekomanduar per dhenie te kontrates nje OE qe nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunes se Prishtines me datën 07.04.2023 ka bere publikimin e njoftimit B58-Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku, ne menyre te kmunder ligjshme ka rekomanduar OE e pa pergjegjshem i cili nuk i ka plotesuar kriteret e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT, tek kerketat mbi mundesite teknike dhe profesionale 9.1 dhe 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional AK ka kerkuar "a) OE duhet te deklarohet se do ti punësoj minimumi 77 punëtorë nga lista e Autoritetit Kontraktues, ndërsa per kryerjen e këtyre shërbimeve duhet ti shtoj edhe 38 punëtor nga personeli i tij dhe 6 punëtor mobil, gjithsej 118 punëtorë. b) OE duhet te deklarohet se do ti paguan te gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori ne BRUTO prej 300.00 euro me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit te Punës Nr.03/L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se" deshmite e kerkuara dokumentare 2. a), b)Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare te detajuar (origjinal).

OE i rekomanduar per kontrate i ka llogaritur gabimisht numrin e punetoreve pasi qe AK ne kerkese ka kerkuar qe ti punesoj minimumi 77 punetore nga lista e AK-se ndersa per kryerjen e

sherbimeve duhet ti shtoj edhe 38 punetore nga personeli i ti dhe 6 punetore mobil qe gjithsej jane 121 punetore, ndersa OE i rekomanduar per kontrate, ne analizen financiare i ka llogaritur pagat vetem per 118 punetore, pra per 3 punetore me pak se sa kerkesa e AK-se. Nese i llogaritim edhe keta 3 punetore sipas kerkeses se AK-se NJK dhe DT atehere ky OE ka gabime aritmetikore me shume se 2% qe automatikisht konform LPP-se eshte i pa pergjegjeshem.

Gjithashtu OE i rekomanduar per kontrate eshte i pa pergjegjshem pasi qe nuk i ka llogaritur pushimet vjetore sipas Ligjit te punes 03/L-212.

Sa i perket pushimeve vjetore OE i shpallur fitues per 15 muaj ka llogaritur vetem 11,201 euro.

Kjo shume kur te pjestohet per 15 muaj eshte e barabarte me 746.73 euro, ndersa sipas ligjit duhet te jene

$121 \text{ punetore} \times 176 \text{ ore} = 21,296 \text{ ore pune per 1 vit}$

$21,296 / 12 \text{ muaj} = 1,774.67 \text{ €}$, shuma prej 1,774.67 € pjestohet me 176 ore pune aq sa eshte pushimi vjetor, kjo eshte e barabarte me 10.08 punetor qe duhet te zevendesohen gjate ter vitit per pushime vjetore.

10.08 puntore kur te shumzohen me pagen bruto 315 € duke e llogaritur edhe 5% punedhensit kjo eshte e barabarte me $10.08 \times 315 \text{ €} = 3,176.25 \text{ €}$ shuma e kontributeve me te gjitha tatimet sipas ligjit pa e llogaritur TVSH-ne.

AK ka rekomanduar për kontrate një GOE te cilët nuk kane dorëzuar fare këto dokumente te cilat i ka kërkuar AK ne DT sipas pikës 11.1 Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik si ne vijim:

- a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;

këtë deklaratë nuk e kane dorëzuar e cila është dashur te dorëzohet si e veçante dhe te deklarojnë qarte se të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës.

- b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

këtë deklaratë nuk e kane dorëzuar e cila është dashur te dorëzohet si e veçante duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit

- c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit;

këtë deklaratë nuk e kanë dorëzuar e cila është dashur të dorëzohet si e veçante nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit GOE i kanë kopjuar me një VEND të gjitha këto shënime dhe i kanë nënshkruar në fund duke ja vendosur titullin: MARREVESHJE NE KONZORCIUM

Pra GOE është dashur të dorëzojë tri deklaratë të ndryshme veç e veç sipas kërkesës së DT-së dhe të konfirmojnë se ju përmbahen atyre kushteve të atyre deklaratave pra të deklarohen lidhur me ato kushte e jo vetëm një marrëveshje. Shihet qartë se ky GOE është i pa përgjegjshëm dhe AK menjëherë është dashur ta eliminojë.

Per me tepër kjo është në kundërshtim edhe me udhëzuesin e prokurimit publik nën 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së ku në tabelle është dhënë si në vijim:

Mungon deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklaratë e nënshkruar nga secili anëtar për konfirmim të pjesëmarrjes	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Mungon deklaratë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm pasi që ka ofertuar me cmime jo normalisht të ulëta ku si shembull tek pozicioni 12 dhe pozicioni 5 ka ofruar cmime vetëm për 0.20 € për liter ndërsa nëse i marrim cmimet e tregut vetëm ambalazhi nuk mund të sigurohet me këto cmime e cila kushton gati 2 fish vetëm ambalazhi e lërmë i tërë produkti me ambalazh i cili kushton me shumë se 3 here sesa cmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë.

Çka është me e rëndësishmja OE i rekomanduar për kontratë edhe sikur ti kishte plotësuar të gjitha kërkesat e NJK dhe DT nuk ka vendosur cmim për njësi në pozicion tek rekapitullimi

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM					
Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
I. Paramasa e sipërfaqeve të mbrendshme	m ²	61,348.00	0.49 €	30,060.96 €	450,914.42 €
II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme	m ²	46,794.90	0.32 €	14,974.37 €	224,615.52 €
III. Paramasa e shpenzimeve higjienike	m ²	1		1,160.50 €	17,406.65 €
				46,195.83 €	692,936.59 €

Mungon çmimi per njesi

SH.P.K.
INTERNACIONAL GROUP BASE
811412725
Prishtinë

Gjithashtu neve kemi pretendimet tona edhe per OE te cilet ne menyre te njejte kane gabuar ne llogaritjen e numrit te punetoreve te cilet i kane llogaritur gjithses 118 punetore e jo 121 punetore aq sa ka kerkuer AK, qe automatikisht edhe keta OE te tjere jane te pa pergjigjshem.

Neve kemi ofertuar me tender te pergjegjshem dhe me Çmimin ekonomikisht me te favorshem. Me vendimin e AK-se për eliminim nga ky aktivitet i prokurimit jemi te diskriminuar drejt për se drejti nga AK dhe AK ne vend qe te na ftoj për nënshkrimin e kontratës AK kundërligjshëm na eliminon.

Me këtë veprim AK ka bere shkelje te nenit 1 te LPP-së ku thuhet se: *vendimet e AK-ve, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.*

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu shihet qarte se AK ka bere shkelje te nenit 7 te LPP-së ku ne piken 1 thuhet se : Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Si dhe ne piken 2 thuhet :

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

AK për këtë aktivitet te prokurimit: ekzaminimin vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP-së.

Pra neve kemi dorëzuar tender i cili është ne përputhshmëri me te gjitha kërkesat e parashtruara ne njoftimin për kontrate dhe dosje te tenderit.

Besojmë se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne këtë aktivitet te Prokurimit andaj, Kërkojmë nga AK qe ti respektoj ne përpikëri dispozitat ligjore qe janë ne fuqi lidhur me kete lloj te aktivitetit te prokurimit dhe te nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e grupit të Operatoreve Ekonomik : "Aroma Plus" SH.P.K. ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi i objekteve per shkollat fillore ne Komunen tte Prishtines me nr te prokurimit: 616-23-1001-2-1-1 te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunes se Prishtines.

ANULOHET njoftimi i Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunes se Prishtines ne lidhje me aktivitetin e prokurimit: Pastrimi i objekteve per shkollat fillore ne Komunen tte Prishtines me nr te prokurimit: 616-23-1001-2-1-1 dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe pas rivlerësimit te shpallemi fitues i këtij aktiviteti te prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshimi pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin ne pergaditjen e ofertave, sigurimin e ofertes, shpenzimet per sherbime te avokatise dhe fitimin e humbur.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

Autoriteti Kontraktues duke respektuar nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik, në respektim të nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik si dhe dispozitat e Rregullores për Prokurimin Publik dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik ka bërë vlerësimin e ofertave dhe në harmoni me kriteret e dosjes së tenderit.

Operatori Ekonomik ankimor ka paraqitur pretendimet ankimore dhe në pretendimin e parë ka theksuar se nuk është kërkuar deklaratë për përmbushjen e shpeshtësisë së pastrimit tek kriteri i dhënies së kontratës i cili ka qenë kriter ekonomikisht më i favorshëm.

Sa i përket pretendimit 4: Operatori Ekonomik ankimor AROMA PLUS shpk nuk ka dorëzuar deklaratë të garancionit dhe deklaratë të mirëmbajtjes të cilat janë kriteret obligative të përmbushjes që janë kritere të dhënies për tenderin ekonomikisht të favorshëm. Dosja e tenderit ka specifikuar qartë kriterin e dhënies Ekonomikisht të favorshëm si në vijim:

Kriteret e dhënies së kontratës

Kategoritë		Përshkrimi i kritereve	Pesha	Metoda e Vlerësimit
1	Çmimi	Pikët <100x70 %> për tenderin me çmimin më të ulët. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	70%	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]$
2	Operimi (shpeshtësia e pastrimit të sipërfaqeve sipas paramasës) min. 1 herë max 3 herë	Pikët <100x30%> për tenderin me shpeshtësinë më të madhe të pastrimit. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht	30%	$D = \frac{D_s}{D_t} \times [100x\%]$
			100 %	

P_s – Çmimi më i ulët;

P_t – Çmimi i tenderit.

D_s – shpeshtësia e pastrimit e tenderuesit;

D_t – shpeshtësia më e madhe e pastrimit

Sipas nenit 27 të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022:

Neni 27 par.7 - Kriteri i dhënies së kontratës:

27.7 Kur bëhet dhënia e kontratës në bazë të kriterit “tenderi ekonomikisht më i favorshëm”, dosja e tenderit dhe, nëse aplikohet, njoftimi për kontratë duhet të deklarojë të gjitha kriteret (në një mënyrë objektive dhe të matshme) që aplikohet në procesin e dhënies, dhënia e peshëve relative (në kushte monetare) të përcaktuara për secilin kriter. Ato duhet të paraqesin vendosjen dhe të bëhen të ditura për tenderuesit. Kriteria të reja ose të amendamentuara nuk duhet të prezantohen gjatë procedurës së dhënies së kontratës. Nëse autoriteti kontraktues gjatë procedurës së prokurimit kupton që kriteret e përdorura janë të papërshtatshme për të përcaktuar tenderin ekonomikisht më të favorshëm, përmirësimi i vetëm i situatës është anulimi i procedurës dhe tenderit.

27.8 Është obligim i Departamentit/ Njesisë së Prokurimit/ të siguroj që blerja më e mirë (vlera ekonomikisht më e favorshme) të sigurohet duke marrur parasysh kombinimin optimal të kostos, të cilat do të përfshijë kostot totale të ciklit të jetës së mallrave, punëve ose shërbimeve. Është e nevojshme të shikohen të gjitha kostot që do të kontribuojnë kostot e mirëmbajtjes dhe kostot Operative të projektit që do të jenë të arsyeshme, gjatë jetë gjatësisë së projektit. Nuk është vetëm kostoja e artikujve, mallrave ose shërbimeve në tender, por përfshirja e të gjitha kostove, direkte dhe indirekte, siç janë:

Kostoja e artikujve + Kostot operative

Kosto e artikullit + Kostot e artikujve të shpenzueshëm (artikujt e përdorur me pajisje)

Kosto e artikullit + Kostot funksionale (kostot Operative)

Kosto e artikullit + Resurset njerëzore të përfshira (kostot e fuqisë punëtore)

Kosto e artikullit + Kostoja e listës së pjesëve rezervë të rekomanduara

Kosto e artikullit + Kostot e mirëmbajtjes / kostot e servisimeve (javore, mujore)

Kosto e artikullit + Kostot e riparimit

Kosto e artikullit + përfshira e kostove të qirasë ose lizingut

Kosto e artikullit + Sigurimi

Kosto e artikullit + Konsideratat për ndikimin në mjedis

Kosto e artikullit + Konsideratat shëndetësore dhe të sigurisë.

27.9 Tenderët duhet të vlerësohen objektivisht dhe në mënyrë transparente krahas kriterëve të peshuara të publikuara. Objektiviteti dhe transparenca arrihet në mënyrën më të mirë me përdorimin e sistemit të vlerësimit me pikë ose shënimeve të pikëve të vlerësuara bazuar në kriteret e peshuara, që tregojnë një vlerësim krahasues të tenderëve nën secilin kriter.

Sa i përket pretendimet të dytë OE ankimor ka paraqitur se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka plotësuar kriterin e dosjes së tenderit si në vijim:

<p>2. a) OE duhet te deklarohet se do ti punësoj minimumi 77 punëtorë nga lista e Autoritetit Kontraktues, ndërsa per kryerjen e këtyre shërbimeve duhet ti shtoj edhe 38 punëtor nga personeli i tij dhe 6 punëtor mobil, gjithsej <u>118 punëtorë</u>. b) OE duhet te deklarohet se do ti paguan te gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori ne BRUTO prej 300.00 euro me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit te Punës Nr.03/L-212 si dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se</p>	<p>2. a), b) Te dëshmohet me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE si dhe analizën financiare te detajuar (origjinal).</p>
--	---

Autoriteti Publik konform kërkesës së Njësisë së Kërkesës - Drejtorisë për Arsim është kërkuar që gjithsej të jenë 118 punëtor dhe jo 121 punëtor andaj edhe në kërkesë në dosje të tenderit shihet qartë që numri total i punëtorëve është 118 dhe jo 121 punëtor. Andaj përshkrimi i çmimit në dosje të tenderit nuk ka të bëjë me numrin e punëtorëve por ka të bëjë me sasinë e sipërfaqeve për të pastruar. Andaj gabimi teknik tek numri i punëtorëve arsyetohet me atë se është kërkuar gjithsej 118 punëtor dhe deklaratat e kërkuara të detyrueshme kanë pasuar tekstin e kërkuar në dispozitë të dosjes së tenderit të lartcekur.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka paraqitur deklaratën e nënshkruar dhe e vulosur konform kërkesës së dosjes së tenderit si në vijim:

MARRËVESHJE NË KONZORCIUM
NDËRMJET

1. Kompania "**INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.** me numër të biznesit 811412725 me adresë Prishtinë.
2. Kompania N.P.SH. "**ARIANITI-A**" me numër të biznesit 810260109 me adresë në GILAN.
3. Kompania "**Skyfterat – Live**" SH.P.K. me numër të biznesit 811046540 me adresë në Ferizaj.

E lidhur në Prishtinë më 28.03.2023

Marrëveshje e lidhur për shpalljen publike nga KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Titulli: Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës

Numër i prokurimit: 616-23-1001-2-1-1

Kompanit në konzorcium arrin marrëveshje në mbështetje profesionale dhe ligjore sipas kërkesave të lejuara në parimet e punës, si dhe rregullave ligjore të Ligjit mbi Prokurim Publik, deklarojm se e mbështesim kompanin "**INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K** të dhënat në piken (1), lidhur më të gjitha kërkesat e ligjore, profesionale dhe teknike. Duke deklaruar për pikat (a), (b), (c), (d), (e).

- a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës;
- b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;


- c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit;

(autorizimi i është dhënë kompanisë "INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.P.K lidere e grupit në konzorcim).

- d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
- e. Secili anëtar i grupit të Operatoreve ekonomik duhet të regjistrohet në platformën elektronike

Antarët e konzorciumit:

"INTERNACIONAL GROUP BASE" SH.P.K



N.P.SH. "ARIANITI-A"



"Skyfiterat Live" SH.P.K



Për: KOMUNE E PRISHTINES

Lënda: Deklaratë

Refefuar tenderit me numër prokurimi: 616-23-1001-2-1-1

Titull : Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës

Deklaratë

Kompania e "INTERNACIONAL GROUP BASE " sh.p.k me numër të bizesit 811412725, me Selin Qendore në Prishtinë pn. Deklaron për KPR se Kompania IGB, është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tendedit

Deklarojm se pastrimin e shkollave do ta bëjmë së paku 6 herë Brenda orarëve të shkollave ku niveli I pastërtisë do të jetë I lartë dhe nënkontroll.

Që I bie 3 herë paradite dhe 3 herë masdite, dhe furnizimet me material do bëhet konform nevojave që shfaqen në baza ditore,javore dhe mujore.



Për: KOMUNE E PRISHTINES

Lënda: Deklaratë

Refefuar tenderit me numër prokurimi: 616-23-1001-2-1-1

Titull : "Pastrimi i objekteve shkollore - Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës

Deklaratë

Kompania e "INTERNACIONAL GROUP BASE " sh.p.k me numër të biznesit 811412725, me Selin Qendore në Prishtinë pn. Deklaron për KPR se Kompania IGB, është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tendedit

Deklarojm se të gjitha materilet do të jenë ekologjike dhe MSDS sipas kërkeses se AK të atestuara Konform AK dhe se furnizimi do të bëhet më së largu me datën 05 të muajit.



Për: KOMUNE E PRISHTINES

Lënda: Deklaratë

Refefuar tenderit me numër prokurimi: 616-23-1001-2-1-1

Titull : "Pastrimi i objekteve shkollore - Pastrimi i objekteve për shkollat fillore në Komunë të Prishtinës

Deklaratë

Kompania e "INTERNACIONAL GROUP BASE" sh.p.k me numër të bizesit 811412725, me Selin Qendore në Prishtinë pn. Deklaron për KPR se Kompania IGB, është pajtuar në përgjithësi me kërkesat në dosjen e tenderit

- Me këtë deklaratë deklarojm se pajtohemi dhe zotohemi se do të respektojm kërkesen tuaj se pranojm të punësojm 77 punëtorë nga Lista e Autoritetit Kontraktues dhe per kryerjen e shërbimeve do te shtojm edhe 38 punëtorpastrues nga personeli i tij 6 punëtor mobil, gjithsej 118 punëtorë . b) se do ti paguajm te gjithë punëtorët pagat e njëjta me punëtorët e këtij sektori ne bruto prej 300.00 euro. me te gjitha obligimet ligjore sipas Ligjit te Punës Nr.03 L-212 dhe ligjeve tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës si dhe ATK-se.

Administrata



Poashtu nuk është kërkuar analizë financiare për pagat e punëtorëve në dosje të tenderit.

Sa i përket pretendimet të tretë lidhur me atë se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e ka plotësuar përshkrimin e çmimit në pozicionin si në vijim nuk ndikon në gabime aritmetike në asnjë mënyrë për arsye se është dhënë çmim njësi për muaj dhe kalkulimi për çmimin njësi 1 është **0.97 € (cent)** pavarësisht që nuk është paraqitur tek çmimi njësi këtu nuk kemi të bëjmë me gabim aritmetik por me gabim teknik dhe kur kalkulohet vlera totale për 1 muaj dhe vlera totale për 15 muaj nuk ndryshon vlera e paraqitur dhe nuk kemi të bëjmë fare me gabime aritmetike nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës i cili ka paraqitur përshkrimin e çmimit si në vijim:

Periudha nga 1 prill 2023 deri më 30 qershor 2024

PARAMASA: SHËRBIET E PASTRIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE (HAPASIRAT E BRENDSHME DHE TË JASHTME) KONTRATË KORNIZË						
I. Paramasa e sipërfaqeve të mbrendshme						
Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njësi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj	
1	Shkolla Filllore Dardania	m ²	6,143.20	0.49	3,010.17	45,152.52
2	Shkolla Filllore Naim Frasheri	m ²	4,900.00	0.49	2,401.00	36,015.00
3	Shkolla Filllore Gjergj Fishta	m ²	4,550.00	0.49	2,229.50	33,442.50
4	Shkolla Filllore Ismail Qemali	m ²	5,460.00	0.49	2,675.40	40,131.00
5	Shkolla Filllore Pjeter Bogdani	m ²	1,939.00	0.49	950.11	14,251.65
6	Shkolla e Gjelbert	m ²	2,186.00	0.49	1,071.14	16,067.10
7	Shkolla Filllore Mehmet Xhevozi	m ²	4,876.00	0.49	2,389.24	35,838.60
8	Aneksi i Shkolles Dardania	m ²	683.00	0.49	334.67	5,020.05
9	Aneksi i Shkolles Naim Frasheri	m ²	1,251.70	0.49	613.33	9,200.00
10	Shkolla Filllore Asim Vekshi	m ²	5,180.00	0.49	2,538.20	38,073.00
11	Shkolla Filllore Ditet e Minatorit	m ²	1,500.00	0.49	735.00	11,025.00
12	Shkolla Filllore Nazim Gafurri	m ²	1,000.00	0.49	490.00	7,350.00
13	Shkolla Filllore Faik Konica	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
14	Shkolla Filllore Pavaresia	m ²	1,000.00	0.49	490.00	7,350.00
15	Shkolla Filllore Mitrush Kuteli	m ²	1,000.00	0.49	490.00	7,350.00
16	Shkolla Filllore Emin Duraku	m ²	1,500.00	0.49	735.00	11,025.00
17	Shkolla Filllore Meto Bajraktari	m ²	2,000.00	0.49	980.00	14,700.00
18	Shkolla fillore Hilmi Rakovica	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
19	Shkolla Filllore Teuta (Grashticë)	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
20	Shkolla Filllore 7 Marsi	m ²	1,000.00	0.49	490.00	7,350.00
21	Shkolla Filllore Hasan Prishtina	m ²	1,000.00	0.49	490.00	7,350.00
22	Shkolla Filllore Xhavit Ahmeti	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
23	Shkolla Filllore Iliria	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
24	Shkolla Filllore Azemi e Salihu	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
25	Shkolla Filllore Shkendija	m ²	1,000.00	0.49	490.00	7,350.00
26	Shkolla Filllore Isa Boletini (Busi)	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
27	Shkolla Filllore Elena Gjika	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
28	Shkolla Filllore Andon Z. Cajupi	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
29	Shkolla Filllore Zenel Hajdimi	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
30	Shkolla Filllore Avni Rrustemi (Mramor)	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
31	Shkolla Filllore Ganimete Terbeshi	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
32	Shkolla Filllore Nexhmi Mustafa (Besi)	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
33	Shkolla Filllore Afrim Gashi (Hajvali)	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
34	Shkolla Filllore Ali Kelmendi	m ²	500.00	0.49	245.00	3,675.00
35	Shkolla Qamil Batalli	m ²	5,680.00	0.49	2,783.20	41,748.00
Totali:			61,348.90		30,060.96	450,914.42

II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme

SH.P.K.
INTERNACIONAL GROUP BASE
811412725
Prishtinë

N.r	Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
1	Siperfaqe te jashtme te gjelbruara	m ²	30,577.00	0.32	9,784.64	146,769.60
2	Kulmi i Gjelbert	m ²	750.00	0.32	240.00	3,600.00
3	Siperfaqe te jashtme me asfalt	m ²	2,642.00	0.32	845.44	12,681.60
4	Siperfaqet me Beton	m ²	9,396.00	0.32	3,006.72	45,100.80
5	Fusha Sportive	m ²	3,429.90	0.32	1,097.57	16,463.52
Totali			46,794.90		14,974.37	224,615.52

III. Paramasa e shpenzimeve higjenike

Materiali për Higjen për një muaj	Njësia	Sasia/muaj	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
1 Paloma katrore C(komplete)1/220	copë	350	€ 0.90	315.00 €	4,725.00 €
2 vim i lagur 0.75 L	Cope	100	€ 0.50	50.00 €	750.00 €
3 Palom role për WC 1/10	copë	500	€ 0.35	175.00 €	2,625.00 €
4 Shampon për duar 1 L	Lit	250	€ 0.30	75.00 €	1,125.00 €
5 Shampon per pastrimin e dyshemeve te rendomta	Lit/cope	300	€ 0.20	60.00 €	900.00 €
6 Domestos ose ekuivalent	Lit	200	€ 0.50	100.00 €	1,500.00 €
7 Thasë për mbeturina 120 Lit	Copë1/10	250	€ 0.40	100.00 €	1,500.00 €
8 Thasë për mbeturina 60 Lit	Copë1/10	200	€ 0.30	60.00 €	900.00 €
9 Arom për zyre	copë	120	€ 0.40	48.00 €	720.00 €
10 Shampon për xhama 0.75 L	Lit/cope	150	€ 0.20	30.00 €	450.00 €
11 klor (guralec) per guac dhe lavaman	kg	50	€ 0.15	7.50 €	112.50 €
12 Shampon per dysheme te tualetit	Lit/cope	250	€ 0.20	50.00 €	750.00 €
13 Dezedorant per fontane wC	copë	100	€ 0.40	40.00 €	600.00 €
14 Dispenser (aparati) me bateri per aroma ambienti (1x ne 36 muaj)	Cope	50	€ 1.00	50.00 €	750.00 €
Total i materialit per nje muaj				1,160.50 €	17,406.65 €

REKAPITULLIMI I PERGJITHSHEM

Emri i objekteve institucionale	Njësia	Sasia	Cmimi Njesi me TVSH	Totali per 1 muaj	Totali per 15 muaj
1 I. Paramasa e siperfaqeve të mbrendshme	m ²	61,348.90	0.49 €	30,060.96 €	450,914.42 €
2 II. Paramasa e sipërfaqeve të jashtme	m ²	46,794.90	0.32 €	14,974.37 €	224,615.52 €
3 III. Paramasa e shpenzimeve higjenike	m ²	1		1,160.50 €	17,406.65 €
				46,195.83 €	692,936.59 €

SH.P.K.
INTERNACIONAL GROUP BASE
811412725
Prishtinë

Andaj në bazë të asaj që është lartcekur autoriteti publik vendos si në dispozitiv.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik – E-Prokurimi
Arkivit

Visar Shehu – U.D. Departamenti i Prokurimit

